



**FSSHK**

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës  
The Trade Union Health Federation of Kosova  
Federacija Sindikata Zdravstva Kosova

---

Prishtinë 22.05 .2017

Për: Levizjen Vetvendosje

Të nderuar,

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes në shëndetësi , në interes të popullit dhe punëtorëve shëndetësor, në pajtueshmëri me Platformën e veprimit sindikal, FSSHK kërkon nga Ju që ti merrni në konsideratë, ti shqyrtoni dhe të deklaroheni në lidhje me gjendjen në shëndetësinë kosovare.

Kërkojmë nga Ju që të jeni sa më transparent dhe korrekt me publikun e gjerë kosovar.

Kërkesat të cilat po ju adresojmë janë kërkesa nga anëtarësia jonë dhe më gjerë, pra votuesit tuaj potencial.

Pra qëllimi është i vetëm dhe i vetëm për një shëndetësi më të mirë.

Kërkesat:

1. FSSHK kërkon nga Partitë Politike që Shëndetësia të jetë Prioritet mbi Prioritetet;
2. FSSHK kërkon që buxheti i sistemit shëndetësor nga Bruto Produkti Vendor(BPV) të rritet në bazë të nevojave vjetore;
3. FSSHK kërkon nga Partia Politike fituese e zgjedhjeve që në programin e saj qeverisës për shëndetësi të parasheh politika unifikuese në sistemin shëndetësor në të tri nivelet, atë primar sekondar dhe terciar duke promovuar decentralizimin në menaxhim të këtyre sistemeve(integrimi i nivelit primar);

4. FSSHK kërkon nga Partia Politike fituese e zgjedhjeve që të bëj ngritjen e pagave të punëtorëve shëndetësor (nuk ka pasur ngritje pagash për 3 vite, e inflacioni e ka bërë të vetën);
5. Me qëllim të gjithë përfshirjes dhe rregullimit të statusit të punëtorëve shëndetësor, FSSHK kërkon që Ligji i pagave i cili parasheh përcaktimin e koeficienteve për të gjithë të punësuarit në sektorin publik me theks të veçantë të punëtorëve shëndetësor, të bëhet bashkërisht me përfaqësuesit e punëtorëve shëndetësor;
6. FSSHK kërkon që pagesa për rrezikshmërinë në vendin e punës, e rregulluar me ligj, si dhe akte të brendshme, të përfshihet në rishikimin e buxhetit për vitin 2017;
7. FSSHK kërkon nga Partia Politike fituese e zgjedhjeve të rrisë numrin e punëtorëve shëndetësor konform standardeve ndërkombëtare për ofrim të shërbimit cilësor shëndetësor (vërejtje mungesë e punëtorëve shëndetësor rreth 5000);
8. FSSHK kërkon që në programin qeverisës për shëndetësi, të Partive Politike, përmirësimi i kushteve, përmes furnizimit me barna, materialit harxhues dhe pajisjet mjekësore (aparaturat) të jenë me prioritet;
9. FSSHK kërkon që fillimi i mbledhjes së premieeve për sigurime shëndetësore të konsistojë me plotësimin e legjislacionit primar dhe sekondar si dhe transparencës të institucioneve përgjegjëse për mbledhjen e pagesës së premieeve për sigurim të obligueshëm shëndetësor;
10. FSSHK kërkon që sistemi informativ shëndetësor të jetë funksional në tërë RKS;
11. FSSHK kërkon që Partitë Politike në programet e tyre qeverisës për shëndetësi ta rregullojnë planifikimin dhe ndarjen proporcionale të specializimeve sipas nevojave të popullatës;
12. Përmirësimi i imazhit të punëtorëve shëndetësor përmes politikave programore qeverisëse (mbrojtja e tyre prej linçimit publik);
13. Të ngrihet në nivel më të lartë dialogu social (i cili për tre vite ka munguar).

Të nderuar, kërkesat tona vijnë nga baza dhe hulumtimet tona, qëllimi ynë është i qartë Shëndetësi më të mirë.

Të gjitha këto kërkesa kërkojnë afate kohore gjë për të cilën ne jemi të vetëdijshëm dhe zgjidhja e tyre të rangohet në çështje: akute, afat shkurte dhe afatgjate, e të cilat duhet t'i zgjedhim bashkërisht.

Ne jemi për bashkëpunim dhe kontraktim të një shëndetësie me të mirë në Republikën e Kosovës po JU?!...



Kryetari, IFSSHK-së  
Dr. Blerim Sylja

LËVIZJA	
<b>VETËVENDOSJEI</b>	
DALËSE	
Nr. Prot	<u>0031KL10130</u>
Nr. i fq.	<u>345</u>
Data	<u>22/05/2017</u>